



Nr. 26/prot  
Dt. 28/04/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. Serial 000148



**LEJE**

**PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR**

Nr.245 Prot., datë 29/04/2021

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr.20, datë 23/04/2021

Emri i individit/subjektit: "SIMA-COM"&"ROLAND" SH.P.K  
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/NIPT): L01502020G & K31327040D  
Baseni Ujor: DRIN-BUNË  
Qarku: SHKODËR  
Bashkia/Njësia administrative: PUKË/QERRET I VOGËL  
Koordinatat e veprave të marrjes: X = 488700; Y = 4650259; Z = 574;  
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. PËR PRODHIM  
HIDROENERGJIE (H/C GOMSIQE E BJESHKËS).  
Burimi ujqor: PËRROI GOMSIQE E BJESHKËS  
Prurja mesatare vjetore 634 l/s  
Prurja ekologjike 80 l/s  
Sasia e ujqit që jepet për përdorim 880 l/s  
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) 76032 m<sup>3</sup>/ditë  
Koordinatat ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer: X = 486517; Y=4650297; Z=405.6  
Koordinatat e shkarkimit të ujërave të përdorura: X = 486517; Y=4650297; Z=405.6  
Sipërfaqja e tokës, së cilës i shërben përdorimi i ujqit (në rastin e ujqitjes): 20 (ha)  
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): Sipas Kushteve të lejes.  
Periudha e vlefshmërisë: 23.04.2021 - 22.04.2026  
Hyrja në fuqi 23.04.2021

**KRYETAR**

**MAJLINDA ANGONI**



### **Kushtet e posaçme të lejes për përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergjë, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor, gjatë ndërtimit dhe operimit të veprave;
11. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujor, me përjashtim të rasteve kur kjo është e miratuar nga organet e administrimit të burimeve ujore;
12. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
13. Të lejojë rrjedhën ekologjike;
14. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
15. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
16. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieveve të rralla;
17. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
18. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore për veprimtarinë përkatëse.